VENDIM
Nr. 594, datë 18.10.2023

PËR KATEGORITË E PUNONJËSVE TË POLICISË USHTARAKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË CILËT PËRFITOJNË SIGURIM JETE, MASAT DHE KRITERET E PËRFITIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 40, të ligjit nr. 13/2015, "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mbrojtjes siguron jetën e personelit të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Kategoritë e personelit të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përfitojnë sigurim jete, janë punonjësit e strukturave të mëposhtme:

a) Sektori i Policisë Kriminale;

b) Inspektorati i Qarkullimit Rrugor;

c) Seksioni i Rendit Ushtarak;

ç) Inspektorati për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin;

d) Toga e Ruajtjes dhe Sigurisë së Personaliteteve në Kompaninë Operacionale të Ruajtjes së Personaliteteve dhe Objekteve të Veçanta.

3. Sigurimi i jetës bëhet sipas kontratës që lidhet me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Ky sigurim mbulon ngjarjet në rastet e:

a) humbjes së jetës për shkak të detyrës apo si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të saj;

b) zhdukjes për shkak të detyrës;

c) paaftësisë së përhershme, të plotë ose të pjesshme, si rezultat i një aksidenti gjatë ushtrimit të detyrës;

ç) paaftësisë së përkohshme, të plotë ose të pjesshme, si rezultat i një aksidenti gjatë ushtrimit të detyrës;

d) shërbimeve mjekësore në spitalet publike ose private jashtë shtetit, kur mbulimet shëndetësore nuk ofrohen në spitalet publike brenda vendit.

4. Shuma e përcaktuar në kontratën e sigurimit, për çdo person të siguruar, nuk mund të jetë më e ulët se:

a) 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, për rastet e humbjes së jetës për shkak të detyrës a zhdukjes së personit;

b) 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për rastet e dëmtimit të rëndë fizik;

c) 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, për rastet e dëmtimit të lehtë fizik;

ç) 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për rastet e humbjes së jetës, si rezultat i aksidenteve gjatë ushtrimit të detyrës.

5. Tarifa e primit të sigurimit përcaktohet në kontratën e sigurimit, por nuk mund të jetë më e ulët se 0.5 %.

6. Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficientëve të përfitimit ndaj dëmtimeve trupore, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shërbejnë si kushte minimale, të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Vendimi nr. 904, datë 11.11.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të përfituesve, të masave e të kritereve për sigurimin e jetës së punonjësit të Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku